

1903
144/1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 2570 Prot

Tiranë, më 29.10. 2021

Lënda: Kthim përgjigje

Z. DORIAN MATLIJA
QENDRA "RESPUBLICA"
Blv. "Gjergj Fishta", Nd.24, H.3, Ap.44

Tiranë

Në vijim të kërkesës suaj për informacion, drejtuar Kuvendit të Shqipërisë, më datë 25.10.2021, dhe bazuar në nenin 2, pika 2 të ligjit nr.119, datë 18.09.2014, "Për të Drejtën e Informimit", gjeni bashkëlidhur një kopje të dokumentacionit të kërkuar, duke përmbushur detyrimin ligjor për dhënie informacioni.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM



Genci GJONÇAJ



KËRKESË

Drejtuar: z.Jllir META

Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

z.Jano SOTIRI

Drejtor i Burimeve Njërezore

Kuvendi i Shqipërisë

Lënda: **Kërkesë për pezullimin e statusit të nënpunësit civil**

I nderuar z.Kryetar,

Me Vendimin e Kuvendit të Shqipërisë, Nr.82/2017 "Për miratimin e listës në bllok të kandidatëve të zgjedhur në Institucionet e rivlerësimit, sipas Ligjit Nr.84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", jam zgjedhur Anëtare e Kolegjit të Apelit.

Në këto kushte bazuar në nenin 53 pika 1 gërma "b", nenit 54 pika 1 gërma "a" kërkoj pezullimin tim nga shërbimi civil, si nënpunëse me detyrë Sekretare e Përgjithshme e Kuvendit të Shqipërisë, deri në përfundim të periudhës përkatëse të emërimit tim në detyrën e Anëtares së Kolegjit të Apelit.

Në pritje të miratimit të kërkesës,

Me respekt

ALBANA SHTYLLA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Shërbimi i Burimeve Njerëzore dhe Trajtimit të Deputetëve

Nr. 1723 / Prot.

Tiranë, më 19.06, 2017

V E N D I M

Nr. 16, Datë 19.06, 2017

PËR PEZULLIMIN NGA SHËRBIMI CIVIL TË Znj. Albana SHTYLLA.

Në mbështetje të nenit 53, pika 1, gërma "b" dhe nenit 54, pika 1, gërma "a", të Ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.124, datë 17.2.2016 "Për pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil", Kreu I "Pezullimi", pika 2 si dhe kërkesës të paraqitur me shkresën nr. 1723, datë 17.06.2017 "Kërkesë për pezullimin e statusit të nëpunësit civil",

V E N D O S:

1. Pezullimin nga shërbimi civil i Kuvendit dhe detyra "sekretar i përgjithshëm", i Kuvendit të Shqipërisë, të Znj. Albana SHTYLLA, për periudhën e emërimit në detyrën e anëtares së Kolegjit të Apelit.
2. Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.124, datë 17.2.2016 "Për pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil", kreu II "Lirimi nga shërbimi civil", pikat 21,27,28,29 dhe 30, nga data 18.06.2017 deri më 19.06.2017, të dorëzojë dokumentacionin dhe materialet që ajo ka në ngarkim.
3. Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.109, datë 26.02.2014 "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil", i ndryshuar, Kreu III "Detyrat e nëpunësve të përfshirë në procesin e vlerësimit të rezultateve në punë", pika 6, ju mbartni detyrimin për vlerësimin e punës, të nëpunësve civil të institucionit, për periudhën 04.01.2017 deri më 18.06.2017 në pozicionin e "zyrtarit raportues", "kunderfirmues" dhe "autorizues".
4. Në zbatim të VKM nr.511, date 24.10.2002, kreu II, pika 5 për periudhën e punës në Kuvend, janar – qershor 2017, i takojnë 2 javë kalendrike të lejes së pushimit vjetor të paguar të vitit 2017, të cilat nuk i ka kryer.
5. Marrëdhëniet e saj financiare me Kuvendin, të ndërpriten në datën 19.06.2017.

1. 20
Përgarkohet Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm, Shërbimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Shërbimi i Financës dhe Buxhetit për dorëzimin e dokumentacionit, materialeve në ngarkim dhe kryerjen e pagesave.

7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Jano SOTIRI



DREJTOR

Tir. kopjete - 5 (pjesë)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
BYROJA

Nr. 2326/Prot.
4

Tiranë, më 10.10.2017

VENDIM

Nr. 1, datë 10.10.2017

PËR EMËRIMIN E SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM TË KUVENDIT

Në mbështetje të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, nenit 11, pika 6, me propozim të Kryetarit të Kuvendit, Byroja e Kuvendit,

VENDOSI:

1. Të emërojë Zotin Genci GJONÇAJ, në detyrën "Sekretar i Përgjithshëm" i Kuvendit.
2. Ngarkohet Shërbimi Administrativ për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Gramoz Ruci

